



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
SEKTORI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE, LETRAVE DHE PLATFORMËS
SË BASHKËQEVERISJES**

Nr.3006/ 1 prot.

Tiranë, më 09.04.2025

Lënda: Mbi kërkesën e z. N. Gj.

**DREJTORISË RAJONALE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE
TIRANË**

**Për dijeni: Z. N. Gj.
Adresa: Blv. “Gjergj Fishta”,**

Tiranë.

Zoti N. Gj. ka paraqitur pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) dëshminë e trashëgimisë, me kërkesën e protokolluar me nr.3506, dt:27.03.2025, dhe ka kërkuar tërheqjen e pensioneve të papaguara që i takonin nënës së tij të ndjerë, znj. Z. Gj.

Znj. Z. Gj. ka qenë përfituese e pensionit të pleqërisë pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Tiranë, me datë fillimi 27.08.1985, në masën fillestare prej 469 lekësh në muaj, dhe me një vjetërsi pune prej 30 vitesh e 6 muajsh.

Sipas historikut të faturave në sistemin online të pagesës së pensioneve (PCAMS), rezulton se pensioni i saj është tërhequr deri më 30.09.2024. Nga 01.10.2024 deri më 27.11.2024, datë në të cilën znj. Z. Gj. ka ndërruar jetë, pensionet janë të patërhequra.

Nga verifikimet në sistemin e aplikimeve në portalin e-Albania, rezulton se më 06.12.2024, z.Gj. ka aplikuar nëpërmjet llogarisë së nënës së tij të ndjerë, duke iu drejtuar DRSSH Tiranë me kërkesën për mbylljen e pensionit. Pas aplikimit, ai ka dorëzuar në DRSSH Tiranë tre certifikata vdekjeje dhe faturën e shpenzimeve të varrimit, por nuk ka dorëzuar dëshminë e trashëgimisë.

Referuar aplikimit dhe dokumentacionit të dorëzuar, është kryer mbyllja e përhershme e pensionit dhe është gjeneruar në pikën paguese Posta nr. 2, Tiranë, pagesa e vdekjes dhe shpenzimet e varrimit. Gjithashtu, z. Gj., është njoftuar nga ana juaj nëpërmjet thirrjes telefonike, për dorëzimin e dëshmisë së trashëgimisë me anë të shërbimit postar.

Duke qenë se z. Gj. ka dorëzuar dëshminë e trashëgimisë në ISSH, po jua dërgojmë bashkëlidhur kësaj shkrese për të vijuar me procedurat përkatëse për pensionet e patërhequra.

Sipas kapitullit IX “Regullat dhe Procedurat për Pagesën e Pensioneve” të Rregullores nr.1, datë 21.10.2008 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagesën e Pensioneve”, në rastet kur pensionisti që vdes nuk ka tërhequr pensionin mbi një muaj, pensioni i patërhequr u paguhet trashëgimtarëve, sipas dispozitave të Kodit Civil dhe përcaktimeve në marrëveshjen përkatëse.

Sa më sipër, ju lutemi të shqyrtoni kërkesën e z. Gj. konform dispozitave ligjore në fuqi dhe të merren masa që kërkesa e përfituesit të trajtohet brenda afateve të përcaktuara sipas rregullores së ISSH-së.

Në përfundim, ju lutemi të informoni të interesuarin dhe të dërgoni një informacion në Sektorin e Letrave dhe Platformës së Bashkëqeverisjes të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, pranë ISSH-së.

Bashkëlidhur keni kërkesën e z. Gj. dhe dëshminë e trashëgimisë !

Ju faleminderit për mirëkuptimin.